




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primi/jefto/Prodato Received/Delivery	18.05.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
S.KM/SHK	4340	2023	113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.623/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.623/2023 të datës 07.04.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ me adresë banimi Rr. \_\_\_\_\_, Komuna e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 17.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.623/2023 e datës 07.04.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_ i punësuar në pozitën “Nëpunës për Mbrojtje të Mjedisit” në Drejtorinë për Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Obiliqit, me datë 07.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3381/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me mos pajtimin për kategorizimin në klasën profesionale 3, me të cilin është klasifikuar pas hyrjes në fuqi Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku i cili në listën e pagave të muajit mars 2023 figuron në klasën profesional 3, i njëjti pretendon se duhet të kategorizohet në klasën profesionale 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.

02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.04.2023 me numër protokolli 3606/2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa Këshilli më datë 03.05.2023 përmes e-mailit, me numër protokolli 4015/2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Obiliqit me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimi i pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli II/25 të datës 03.01.2013 është i punësuar në pozitën "Nëpunës për Mbrojtje të Mjedisit" me koeficient pesë (5) në Drejtorinë për Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Obiliqit. Ankuesi i pakënaqur me kategorizimin me të cilin është klasifikuar pas hyrjes në fuqi Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili në listën e pagave të muajit mars 2023 figuron në klasën profesionale 3, i njëjti pretendon se duhet të kategorizohet në klasën profesionale 2.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka gjetur se organi i punësimit, konkretisht Komuna e Obiliqit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficientëve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit VNr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje,



gjegjësishtë deri me datë 30.09.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë profesionale 3 është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si më sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së saj të punës.


Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.623/2023

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës

Eshref Shabani

  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivoit të KPMSHCK-së